



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
POSTA SHQIPTARE SH.A

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ___/___/ 2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Dt. 28.08.2020

Për: Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Iliriada” sh.p.k., me NIPT J61828125L

Adresa: Rruga “Artan Lenja”, Pallati “4A-M”, Shkalla 1, Kati i 2, Apartamenti Nr.7, Zone
Kadastrale 8220, Tiranë

&

“4 A–M SHPK” sh.p.k me NIPT K92005016L

Adresa: Rruga “Artan Lenja”, Pallati “4 A-M”, Apartamenti A1, kati i I-rë, **Tiranë.**

* * *

Procedura e prokurimit: Referuar Urdhërit të Prokurimit Nr. **10, datë 25.06.2020** me objekt: **“Rikonstruksion i Filialeve të Postës Berat, Lushnje dhe Fier”**, me fond limit total **43.596.234** (dyzet e tre milion e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e tridhjetë e katër) lekë pa tvsh, të vëna në dispozicion nga të ardhurat e Shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a., me procedurë “E hapur”, me mjete elektronike e cila u zhvillua më datë 03.08.2020, ora 10.00. [Referenca e dosjes nga autoriteti kontraktor]

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-62906-06-25-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Rikonstruksion i Filialeve të Postës Berat, Lushnje dhe Fier”

Fondi Limit: 43.596.234 (dyzet e tre milion e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e tridhjetë e katër) lekë pa tvsh.

Burimi i financimit: Financuar nga të ardhurat e shoqërisë Posta Shqiptare sh.a.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme;

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 03.08.2020, ora 10.00

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike *Datë 29.06.2020 [39]*

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. BO “Arkonstudio” sh.p.k me Nipt L42019004I & “ ED- KONSTRUKSION” me Nipt K61625001I me oferte ekonomike 31.387.808 (tridhjetë e një milion e treqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e tetë) lekë pa TVSH.

2. BO “RAFIN COMPANY” Shpk me Nipt L5215110A. dhe “2Z KONSTRUKSION” me oferte ekonomike **35,877,736.65** (tridhjetë e pesë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë, pikë gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

3. Operatori Ekonomik “I.D.K Konstruksion sh.p.k” me ofertë ekonomike 42,000,000 dyzetë e dymilion) lekë pa TVSH.

4. BO “Iliriada” shpk me Nipt J61828125L & “4 A–M” SHPK me Nipt K92005016L me ofertë ekonomike 43.094.426,80 dyzetë e tre milion e nëntëdhjetë e katër mijë e katërqind e njëzetë e gjashtë presje tetëdhjetë) leke pa TVSH.

5. Operatori ekonomik “BONUS SHPK” me Nipt K72412009E me ofertë ekonomike **43.386.819** (dyzetë e tre milion e treqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëmbëdhjetë) leke pa TVSH.

6. Operatori ekonomik 'BIBA-X' Sh.p.k me Nipt K32618815N me ofertë ekonomike 43.500.000(dyzetë e tremilion e pesëqind mijë) lekë pa Tvsh.

7. Operatori ekonomik “6 D – Plan ” Shpk me Nipt L62717405H, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike dhe dokumentacion.

8. Operatori ekonomik “Midea Albania ” Shpk me Nipt K01510004R, nuk ka paraqitur oferte ekonomike dhe dokumentacion.

9. Operatori ekonomik “Elda – VL” Shpk Nipt K67106202Ë, nuk ka paraqitur ofertë Ekonomike dhe dokumentacion.

Janë skualifikuar operatorët ekonomik të mëposhtëm:

1.BO “Arkonstudio” sh.p.k & “ ED- KONSTRUKSION”

Nuk përmbush pikën **2.3.5/2** pasi **BO nuk kanë të punësuar si drejtues Teknik (të përfshirë në licensën e shoqërisë) për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtëtuuar me kontratë punë të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën Mars – Qershor 2020 stafi inxhinierik si më poshtë:**

- **Inxhinier Elektronik:** (minimum 1) punonjës;
- **Inxhinier Mekanik (Drejtimi materiale):** (minimum 1) punonjës;

Nuk përmbush pikën **2.3.5/2** pasi Bimi i Operatorëve ka paraqitur dokumentacion për vetëm **1 punonjës Inxhinier Elektrik** nga 2 punonjës të kërkuar. Bashkimi i operatorëve ka paraqitur dokumentacion për punonjës të Lindita Gjeka e cila rezulton **Ing. Elektroteknike**, ndërsa në Dst kërkohet **Ing Elektrike**. Anëtar i bashkimit të operatorëve Arcon Studion ka paraqitur dokumentacion punonjës të Ermira Bardha dhe rezulton që Kontrata mes palëve është lidhur në 01.07.2020 dhe si rrjedhojë nuk është staf për periudhën Mars- Qershor 2020 si dhe nuk rezulton në listpagesë për periudhën e kërkuar.

Nuk përmbush pikën **2.3.5/2** pasi Bashkimi i Operatorëve nuk ka paraqitur dokumentacion për **Inxhinier Elektronik**

Nuk përmbush pikën 2.3.5/2 pasi Bashkimi i Operatorëve nuk ka paraqitur dokumentacion për Inxhinier Mekanik (Drejtimi materiale): Anëtari i bashkimit të operatorëve Arcon Studion ka paraqitur dokumentacion punonjësish Edmond Leka dhe rezulton që Kontrata mes palëve është lidhur në 01.07.2020 dhe si rrjedhojë nuk është staf për periudhën Mars- Qershor 2020 si dhe nuk rezulton në listpagesë për periudhën e kërkuar.

Nuk përmbush pikën **2.3.5/2** pasi BO nuk ka paraqitur dokumentacion për **Kimist Mjedisi**: Anëtari i bashkimit të operatorëve Arcon Studion ka paraqitur dokumentacion punonjësish **Irakli Prifti** dhe rezulton që Kontrata mes palëve është lidhur në 01.07.2020 dhe si rrjedhojë nuk është staf për periudhën Mars- Qershor 2020 si dhe nuk rezulton në listpagesë për periudhën e kërkuar.

Nuk përmbush pikën **2.3.5/2** pasi BO nuk ka paraqitur dokumentacion për **Inxhinier Ndërtimi**:

Nuk përmbushet **pika 2.3.8.** pasi konkretisht anëtari i bashkimit të operatorëve Arcon Studion ka Çertifikata ISO 9001-2015 Çertifikata ISO 14001-2015, Çertifikata OHSAS 18001-2007 janë të skaduara në muajin Korrik 2020.

Nuk përmbushet **pika 2.3.8.** pasi konkretisht asnjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve nuk ka paraqitur Rregullore (EU) nr. 333/2011

Nuk përmbushet pika 2.3.9 pasi bashkimi i operatorëve nuk kanë paraqitur Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike dhe konkretisht për Kamionçinë (kapaciteti mbajtës minimum 2 (dy) ton dhe maksimumi 4 (katër) ton për secilin kamionçinë. Është paraqitur dokumentacion vetëm për 1 kamionçinë ndërsa në dst janë kërkuar dokumentacion për 5 kamionçina.

2. BO ekonomik “RAFIN COMPANY” Shpk me Nipt L5215110A. dhe “2Z KONSTRUKSION” me oferte ekonomike **35,877,736.65** (tridhjetë e pesë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë, pikë gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Nuk përmbush pikën **2.3.5/2** pasi *Operatori Rafin Konstruksion* **nuk** ka paraqitur Listpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **qershor 2020** shoqëruar me formularin e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Nuk përmbush pikën **2.3.5** pasi *Operatori “2 Z Konstruksion”* nuk plotëson kriterin për kapacitetin teknik, pasi ka një punësim mesatar për 33 persona ndërkohë që në përputhje me përqindjen e kontratës së bashkëpunimit duhet të kishte minimumi **44 persona** personave, për periudhën Mars 2020 - Qershor 2020.

Nuk përmbush pikën **2.3.5** pasi BO ekonomik pjesëmarrës “2 Z Konstruksion” & Rafin Konstruksion” **nuk kanë** të punësuar si drejtues Teknik (të përfshirë në liçensën e shoqërisë) për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtëtuar me kontratë punë të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën Mars – Qershor 2020 stafi inxhinierik si më poshtë:

➤ **Inxhinier Elektronik:** (minimum 1) punonjës;

➤ **Inxhinier Mekanik (Drejtimi materiale):** (minimum 1) punonjës;

Nuk përmbush pikën **2.3.5 pasi BO ekonomik pjesëmarrës “2 Z Konstruksion” & Rafin Konstruksion” nuk kanë** në stafin e tij të punësuar dhe të rregjistruar sipas legjislacionit në fuqi për periudhën Mars Qershor 2020:

➤ **Kimist Mjedisi:** (minimum 1) punonjës;

Nuk përmbush pikën 2.3.5/2 pasi nga dokumentacioni i paraqitur nga anëtari i bashkimit të operatorëve 2Z KONSTRUKSION për ing Elektrik Frederik Zere rezulton që nuk është në listepagesë.

Nuk përmbush pikën 2.3.5/2 pasi nga dokumentacioni i paraqitur nga anëtari i Bashkimit të Operatorëve 2Z KONSTRUKSION për ing Mekanik Dode Vladi rezulton që nuk është në listepagesë

Nuk përmbush pikën 2.3.5/2 pasi nga dokumentacioni i paraqitur nga anëtari i Bashkimit të Operatorëve 2Z KONSTRUKSION për ing Mjedisi Evgjani Kola rezulton që nuk është në listepagesë.

Nuk përmbush pikën 2.3.5/2 pasi nga dokumentacioni i paraqitur nga anëtari i Bashkimit të Operatorëve Rafin Company” për ing Elektornik Lavdi Deda rezulton që nuk është në listepagesë për muajin Maj.

Nuk përmbush pikën 2.3.8 pasi Operatori Rafin Konstruksion **nuk** ka paraqitur Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që ka të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes:

➤ **Çertifikata OHSAS 18001-2007 (e vlefshme) ose ekuivalente**

➤ **Rregullore (EU) nr. 333/2011**

Nuk plotësohet **pika 2.3.9** pasi Operatori “2 Z Konstruksion” për mjetet e marra me qira **nuk** ka paraqitur kontrata përkatëse noteriale e qirasë **ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.**

Nuk plotësohet pika 2.3.9 pasi Operatori Rafin Konstruksion për mjetet e marra me qira **nuk** ka paraqitur kontrata përkatëse noteriale e qirasë **ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.**

Operatori Rafin Konstruksion nuk ka paraqitur për drejtues Teknik Adnan Rusi dhe Siri Hamitit (të përfshirë në licensën e shoqërisë kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës, të cilet figurojnë në listpagesat e shoqërisë.

3. Operatori Ekonomik “I.D.K Konstruksion sh.p.k”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton që i nuk i përmbush kriteret e përcaktuara për kualifikim pasi operatori nuk ka paraqitur asnjë Dokument Ligjor, Financiar dhe Teknik.

4. Operatori ekonomik “Elda – VL” Shpk Nipt K67106202Ë, nuk ka paraqitur oferte ekonomike.

5. Operatori ekonomik “BONUS SHPK”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton që i nuk i përmbush kriteret e përcaktuara për kualifikim pasi operatori nuk ka paraqitur Dokumenta Ligjore, Financiare dhe Teknike.

6. Operatori ekonomik 'BIBA-X' Sh.p.k.

Nuk përmbush pikën **1, Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit**, pasi nuk ka dorëzuar deklaratë sipas shtojcës 8.

Nuk përmbush pikën 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, pasi nuk ka dorëzuar deklaratë sipas :

b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*

ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*

dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*

f. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*

g. *Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*

Nuk përmbush pikën **2.3.4** pasi Operatori 'BIBA-X' Sh.p.k, nuk ka dorëzuar deklaratë për përmbushjen e këtij kriteri.

Nuk përmbush piken **2.3.5** pasi Operatori 'BIBA-X' Sh.p.k, nuk ka paraqitur listepagesë për periudhën Qershor 2020.

Nuk përmbush pikën **2.3.5** pasi Operatori 'BIBA-X' Sh.p.k **nuk ka në stafin e tij të punësuar dhe të rregjistruar sipas legjislacionit në fuqi për periudhën Mars Qershor 2020:**

➤ **Kimist Mjedisi:** *(minimum 1) punonjës;*

Nuk përmbush pikën 2.3.8 pasi Operatori 'BIBA-X' Sh.p.k **nuk** ka paraqitur Çertifikatën **Çertifikata ISO 3834-2:2006 (e vlefshme) ose ekuivalente Rregullore (EU) nr. 333/2011**

Nuk plotësohet pika 2.3.9 pasi Operatori “BIBA-X” **nuk** ka paraqitur dokumentacion për mjetet : Kamionçinë (kapacitet mbajtës minimum 2 ton dhe maksimumi 4 ton për seicilin mjet.

Nuk plotësohet pika 2.3.9 pasi Operatori 'BIBA-X' Sh.p.k, nuk ka paraqitur dokumentacion për të pompe suvatimi.

Nuk plotësohet pika 2.3.9 pasi Operatori 'BIBA-X' Sh.p.k, ka paraqitur dokumentacion vetëm për 1 kompresor, ndërkohë që nga Autoriteti kontraktor kërkohen 2.

Nuk plotësohet pika 2.3.10 pasi Operatori 'BIBA-X' Sh.p.k, nuk ka paraqitur deklaratë nga Administratori i Shoqërisë për përmbushjen e këtij kriteri.

7. Operatori ekonomik “6 D – Plan ” Shpk, nuk ka paraqitur oferte ekonomike dhe dokumentacion.

8. Operatori ekonomik “Midea Albania ” Shpk, nuk ka paraqitur oferte ekonomike dhe dokumentacion.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se është identifikuar si operator ekonomik i suksesshëm:

BO Iliriada shpk me Nipt J61828125L & 4 A–M SHPK me Nipt K92005016L me ofertë ekonomike 43.094.426,80 dyzetë e tre milion e nëntëdhjetë e katër mijë e katërqind e njëzetë e gjashtë presje tetëdhjetë) leke pa TVSH. Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoriteti Kontraktor “Posta Shqiptare” sh.a., Adresa: Rr, “Reshit Çollaku”, Nr. 4, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kjo procedurë prokurimi anulohet pasi nuk ka operator ekonomik të klasifikuar vijues siç parashikohet në nenet 24 dhe 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 17.08.2020.

Ankesa: Nuk ka patur.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Laert Duraj